



Prishtinë, 30 mars 2011
Kodi i ZRRE-së: V_340_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të bërë me datë 22.12.2010 nga ndërmarrja "HSE Balkan Energy d.o.o" adresa: Bulevar Mihaila Pupina 117, Belgrad, Serbi.

Në seancën e mbajtur me datë 30 mars 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes HSE Balkan Energy d.o.o, me numër licence ZRRE/Li_36/10 për periudhën nga data **30 mars 2011** deri **30 mars 2013**.

Arsyetim

- ZRRE me datë 22.12.2010 ka pranuar me postë të rregullt aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike nga ndërmarrja HSE Balkan Energy d.o.o.
 - Zyra e Rregullatorit për Energji ka vlerësuar aplikacionin e kompanisë në fjalë, dhe bazuar në kërkesat sipas Aplikacionit, ka kërkuar dokumente shtesë për plotësimin e dokumentacionit gjatë aplikimit për Licencë të Tregtisë me energji elektrike, nga kompania në fjalë.
 - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për Furnizim/tregti me energji elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri në 100 MW.
- III. Nëse i Licencuari HSE Balkan Energy d.o.o dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuara në Nenin 4 të licencës me Nr. ZRRE/Li_36/10, ai duhet të ri aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar